

URDHËR
Nr.1712, datë 18.9.2007

PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN E DOKUMENTIT DHE PROCEDURËN E PËRFITIMIT
TË STATUSIT TË EMIGRANTIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 13, pika 2 të ligjit nr.9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”,

URDHËROJ:

1. Çdo emigrant i regjistruar në “Regjistrin për emigrantët”, që plotëson dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të këtij urdhri, përfiton “Statusin e emigrantit”.

2. “Statusi i emigrantit” është dokumenti zyrtar, sipas formatit bashkëngjitur, i cili identifikon emigrantin, me qëllim gëzimin e përfitimeve të përcaktuara në ligjin nr.9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”.

3. Elemente të përmbajtjes së dokumentit “Statusi i emigrantit” janë:

- a) gjeneralitetet e emigrantit;
- b) statusi i punësimit të emigrantit në momentin e lëshimit të dokumentit;
- c) statusi i pjesëtarit/pjesëtares së familjes së emigrantit;
- d) data e lëshimit të dokumentit;
- e) afati i vlefshmërisë së dokumentit.

4. Për të përfituar “Statusin e emigrantit”, çdo emigrant depoziton në zyrën përkatëse të punësimit, pranë të cilës ai ka bërë regjistrimin në “Regjistrin për emigrantët”, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) për emigrantët të cilët do të largohen:
 - i) kopje origjinale të kontratës së punës të legalizuar, të nënshkruar nga palët (emigranti punëmarrës) ose kopje të noterizuar të saj; ose
 - ii) kopje të noterizuar dhe të legalizuar të dokumentit përkatës, që vërteton statusin e tij si i vetëpunësuar në vendin pritës;
 - iii) certifikatë personale me fotografi;
- b) për familjarët, të cilët do t’i bashkohen emigrantit të larguar/që do të largohet për motive punësimi:
 - i) certifikatë e gjendjes familjare në të cilën të provohet që ai është pjesëtar i familjes së emigrantit;
 - ii) kopje e noterizuar e autorizimit për ribashkim familjar nga vendi pritës;
- c) për emigrantët e rikthyer:
 - i) kopje e pasaportës;
 - ii) deklaratë noteriale në të cilën shprehet vendimi i emigrantit për të punuar apo qëndruar mbi një vit në Republikën e Shqipërisë;
 - iii) certifikatë personale me fotografi;
 - iv) dokumentacioni përkatës, sipas statusit që ka pasur, që vërteton qëndrimin e tij/saj mbi një vit në vendin pritës.

5. Afati i vlefshmërisë së “Statusit të emigrantit” për emigrantët që do të largohen për motive punësimi, do të jetë në përputhje me kohëzgjatjen e kontratës së punës në vendin pritës, nëse nuk ndryshon statusin e tij të punësimit.

Për kategorinë e të vetëpunësuarve dhe të punëdhënësve, do të jetë në përputhje me afatin e përcaktuar në dokumentacionin e regjistrimit të tij pranë organeve fiskale të vendit pritës.

6. Afati i vlefshmërisë së “Statusit të emigrantit”, për familjarët të cilët do t’i bashkohen emigrantit të larguar/që do të largohet për motive punësimi, do të jetë në përputhje me afatin e autorizimit për ribashkim familjar nga vendi pritës.

7. Afati i vlefshmërisë së “Statusit të emigrantit”, për emigrantët e rikthyer do të jetë për një periudhë njëvjeçare.

8. Rinovimi i dokumentit “Statusi i emigrantit”, kërkohet nga subjekti përfitues 30 ditë para

përfundimit të vlefshmërisë së tij. Kërkesa për rinovim shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të këtij urdhri, për kategorinë të cilës i përket emigranti.

Familjarët, të cilët i janë bashkuar emigrantit të larguar, në kërkesën për rinovim të statusit mund të paraqesin edhe lejen e qëndrimit për ribashkim familjar, në rast se janë pajisur me të nga autoritetet e vendit pritës.

9. Zyra përkatëse e punësimit, pasi verifikon nëse dokumentacioni i përcaktuar në pikën 4 të këtij urdhri është i plotë, plotëson dokumentin “Statusi i emigrantit”, i cili firmoset nga drejtori i saj.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka

	
	REPUBLIKA E SHQIPËRISË Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT
	DOKUMENTI “STATUSI I EMIGRANTIT” Për përfituesit e Statusit të Emigrantit

Ky status është i vlefshëm me dokument identifikimi nga dt. __/__/__, deri në dt. __/__/__. Lëshuar në _____	Emër _____ Mbiemër _____ Atësia _____ Datëlindja _____
	Statusi i punësimit i emigrantit _____
	Statusi i pjesëtarit të familjes _____
	Drejtori Zyra Rajonale e Punësimit _____